

# GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

15 qershor 2010  
Prishtinë  
Pkl-Kzz 131/09

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it, Gerrit-Marc Sprenger si kryetar i kolegjit, gjyqtari i EULEX Norbert Koster dhe gjyqtarët Kosovarë Avdi Dinaj, Emine Kaçiku dhe Emine Mustafa si anëtarë të kolegjit, me zyrtarin ligjor të EULEX-it Andrea Chmieliński Bigazzi si procesmbajtës, në lëndën penale Pkl-Kzz nr. 131/09 të Gjykatës Supreme të Kosovës;

Kundër të pandehurit : N. R. mashkull, shqiptar i Kosovës, emri i babait  
! mbiemri i vajzërisë së nënës lindur : , me  
vendbanim në rrugën , i shkolluar, ka  
mbaruar katër vite të shkollës fillore, nuk ka kryer shërbimin ushtarak, me gjendje të  
mesme ekonomike, nuk është i dënuar më parë, në paraburgim që nga 5 prilli 2004;

**I akuzuar me anë të aktakuzës së ndryshuar për kryerje të veprës penale Vrasje të rëndë** (neni 30 paragrafi 5 i Kodit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës KPKSAK-së) lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë KPRSFJ-së, lidhur me nenet 146, 147 paragrafët 5 dhe 6 dhe nenit 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), tri vepra penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm (neni 157 paragrafët 1 dhe 3 të KP të KSAK-së lidhur me nenin 164 paragrafin 2 dhe nenin 22 të KP RSFJ-së, nenin 291 paragrafët 1, 3 dhe 5 lidhur me nenin 23 të KPK-së), tri vepra penale Pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale (neni 200 paragrafi 1 i KP KSAK-së lidhur me nenin 22 të KP RSFJ-së, nenin 320 paragrafin 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së).

**I dënuar në shkallën e parë me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan të datës 19 maj 2005 P.nr. 142/04, për kryerjen e veprave penale:**

- Vrasjes të rëndë, në kundërshtim të neneve 146 dhe 147 pikës 5 Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK-së) lidhur me nenin 23 të KPPK-së;
- Pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale, në kundërshtim të nenit 200 paragrafit 1 të KP KSAK-së;

**Është dënuar me dënim unik prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim, sipas nenit 71 të KPPK-së, i cili është bazuar në dënimin e vetëm prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim për veprën penale Vrasje të rëndë dhe 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim për veprën penale Pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale, përfshirë kohën e kaluar në paraburgim nga data 5 prill 2005 dhe në vazhdimësi, derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë;**

I dënuar në shkallën e dytë sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.-Kz. Nr. 179/2007, të datës 23 qershor 2009, me pranimin e pjeshëm të ankesës së të akuzuarit sa i përket cilësimit ligjor Vrasjes së rëndë sipas nenit 30 paragrafit 2 pikës 5 të KP KSAK-së;

Duke vepruar lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga i Pandehuri dhe gjithashtu nga avokati i tij mbrojtës më 25 nëntor 2009, të dyja kundër aktgjykimit të shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut në Gjilan të datës 19 maj 2005 (P.Nr. 142/04), dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme të datës 23 maj 2009 (Ap.-Kz.Nr. 179/2007);

Duke e pasur parasysh përgjigjen e ZPShK-së të paraqitur më 30 dhjetor 2009, me datë 3 dhjetor 2009 (PKK nr. 138/2009);

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 15 qershor 2010;

Duke vepruar sipas nenit 456 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së).

Lëshon këtë:

### **AKTGJYKIM**

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të pandehurit dhe gjithashtu ajo e avokatit të tij mbrojtës të dyja me datën 25 maj 2009, kundër aktgjykimit të shkallës së parë të datës 19 maj 2005 (P.Nr. 142/04), dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 23 qershor 2009 (Ap.-Kz.Nr. 179/2007)

**Refuzohen si të pabazuara**

## ARSYETIM

### I. Historia e procedurës

Akuza ka të bëjë me Vrasje të rëndë p.sh. e kryer më 17 mars 2004 në Gjilan, Kosovë, ku disa të pandehur në bashkëkryerje me të tjerë kanë marrë jetën e S.P.; kanë lënduar rëndë A.P. dhe kanë dëmtuar pronën e tyre pasi që prona e tyre ishte sulmuar nga një turmë e madhe e zemëruar.

Në bazë të hetimeve të policisë, N.R. është arrestuar më 5 prill 2004; paraburgimi i është vazhduar me anë të aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan të datës 19 maj 2005, deri sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Kundër N.R. dhe pesë bashkëkryerësve të tjerë të pohuar respektivisht A.I., S.S.H., Xh.S., S.S.H. dhe A.A., Prokurori Publik Ndërkombëtar ka paraqitur aktakuzën e datës 28 shtator 2004 me akuza për vrasje të rëndë, dy vepra penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, dy vepra penale pjesëmarrje në grup që kryen vepra penale, kurse Xh.S. gjithashtu është akuzuar për veprën penale posedim i kundërligjshëm i armës dhe municionit pa autorizim ligjor dhe veprën penale pengim i dëshmitëve. Pretendimet kanë të bëjnë me vrasjen e S.P. dhe lëndimet e rënda të marra nga nëna e tij A.P. në 17 mars 2004 në Gjilan.

Për gjashtë të Pandehurit aktakuza është konfirmuar për të gjitha akuzat me aktvendimin e datës 14 tetor 2004.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar pranë Gjykatës së Qarkut në Gjilan më 25 janar 2005, është mbajtur në prani të Prokurorit Publik, të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës dhe ka përfshirë 25 seanca deri më 19 maj 2005. Dëshmi kanë qenë deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe fazës së hetimeve, prej të cilave disa prej tyre kanë qenë anonime, si dhe dëshmitë e të pandehurve në Polici, pranë Gjyqtarit hetues dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor. Disa prova materiale si rrobat e viktimave, fotografitë dhe ekspertizat gjithashtu janë marrë parasysht.

Në seancën e 12 majti 2005 Prokurori ka ndryshuar aktakuzën e tij duke akuzuar:

- 1) N.R. së bashku me A.I. : S.B. dhe Xh.S. për veprën penale Vrasje e rëndë kundër S.P. e kryer në mënyrë mizore dhe të dhunshme dhe/ose për motive racore, nacionale apo fetare;
- 2) N.R. së bashku me A.I. : S.B. : S.S.H. dhe Xh.S. i për veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm me një akt të rrezikshëm të nërgjithshëm kundër S.P.
- 3) N.R. së bashku me A.I. : S.B. : S.S.H. dhe Xh.S. dhe A.A. për veprën penale

Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm me një akt të rrezikshëm të përgjithshëm kundër

4 <sup>A.P.</sup> N.R. së bashku me <sup>A.I.</sup> i, <sup>S.B.</sup> , <sup>S.</sup> dhe <sup>A.A.</sup> për veprën penale

Pjesëmarrje në grup që ka marrë jetën e <sup>S.P.</sup>  
5 N.R. së bashku me <sup>A.T.</sup> <sup>S.B.</sup> , <sup>S.</sup> dhe <sup>A.A.</sup> për veprën penale

Pjesëmarrje në grup që i ka shkaktuar lëndime të rënda <sup>A.P.</sup>  
6 <sup>Xh.S.</sup> për veprën penale Posedim i kundershtueshmëri të armës dhe municionit pa autorizim ligjor ,

7 <sup>Xh.S.</sup> veprën penale Pengim i dëshmitë,

8 N.R. së bashku me <sup>A.I.</sup> <sup>S.B.</sup> , <sup>S.</sup> dhe <sup>A.A.</sup> për veprën penale

Pjesëmarrje në grup që i kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme pronës së <sup>S.P.</sup> <sup>A.P.</sup>

9 N.R. së bashku me <sup>A.I.</sup> , <sup>S.B.</sup> , <sup>S.</sup> dhe <sup>A.A.</sup> për veprën penale

Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm me zjarr i cili ka shkaktuar rrezik të konsiderueshëm pronës së <sup>S.</sup> e <sup>A.P.</sup>

Më 19 maj 2005, Aktgjykimi i shkallës së parë është shpallur duke e dënuar <sup>N.R.</sup> <sup>R.</sup> , është cekur më lart. I pandehuri është liruar nga të gjitha akuzat e mbetura.

Më 12 dhjetor 2006 avokati mbrojtës i të pandehurit <sup>N.R.</sup> ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë Gjykatës së Qarkut në Gjiilan

Prokurori ndërkombëtar ka shprehur mendimin e tij më 28 janar 2009.

Pas dorëzimit të lëndës gjyqtarëve të EULEX-it në janar të vitit 2009, Gjykata Supreme e Kosovës ka caktuar seancën ankimore më 23 qershor 2009 ku kryetari i kolegjit ka dhënë raportin e tij, të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës kanë sqaruar ankesat e tyre, Prokurori ndërkombëtar është përgjigjur, përfundimisht avokatët mbrojtës dhe të pandehurit kanë dhënë deklaratat e tyre të fundit, siç është regjistruar në procesverbal.

Ankesa e paraqitur në dobi të <sup>N.R.</sup> e datës 12 dhjetor 2006 është PRANUAR pjesërisht sa i përket cilësimit juridik të veprës penale Vrasje e rëndë sipas nenit 30, paragrafit 2, pikës 5 të KP të KSAK-së, dhe është REFUZUAR në pjesën e mbetur.

Me aktvendim të ndarë, Gjykata e Qarkut në Gjiilan ka vendosur lidhur me vazhdimin e paraburgimit të <sup>N.R.</sup> pas neneve 426 dhe 393 të KPPK-së. Ankesa kundër këtij aktvendimi është refuzuar nga Gjykata Supreme më 23 shtator 2009. Prandaj, i pandehuri <sup>N.R.</sup> është ende në paraburgim.

Avokati mbrojtës dhe i pandehuri N. R. kohë kanë paraqitur dy kërkesa të ndara për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjyqimeve të shkallës së 1-rë dhe 2-të më 25 nëntor 2009.

ZPShK-ja ka paraqitur mendimin e saj të datës 3 dhjetor 2009, më 30 dhjetor 2009, (PKK nr. 138/2009).

**Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Avokatit Mbrojtës i të pandehurit N. R.** kundërshton aktgjykimet e shkallës së 1-rë dhe 2-të nga aspekte të ndryshme si në vijim:

Aktgjykimi i shkallës së 1-rë kundërshtohet për shkak të:

1. shkeljes esenciale të procedurës penale të nenit 403, paragrafit 1, pikës 12 të KPPPK-së
2. shkeljes së Ligjit penal nenit 404 të KPPPK-së.

Aktgjykimi i shkallës së 2-të kundërshtohet për shkak të shkeljes së Ligjit Penal të Kosovës.

Avokati mbrojtës propozon:

- të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë siç është kërkuar në ankesë,
- të pranohet kërkesa e të Pandehurit,
- të ndryshohet aktgjykimi dhe të lirohet i akuzuari nga përgjegjësia penale, ose
- t'i shqiptohet dënim më i butë, ose
- të priset aktgjykimi dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

**Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të pandehurit N. R.** është paraqitur më 25 nëntor 2009.

Aktgjykimet e shkallës së 1-rë dhe 2-të kundërshtohen për shkak të shkeljeve të ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të procedurës penale (psh. Neni 451, paragrafi 1, nënparagrafët 1 dhe 2).

I pandehuri propozon:

- të priset aktgjykimi i gjykatës së shkallës së 1-rë sa i përket akuzës vrasje e rëndë dhe ai të lirohet nga kjo akuzë, ose
- t'i shqiptohet atij vetëm një dënim lidhur me veprën penale pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale.

**Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK)**, e përfaqësuar nga Kryeprokurori i EULEX-it Theo Jacobs, ka paraqitur mendimin në Gjykatën Supreme të Kosovës më 30 dhjetor 2009 duke argumentuar se kërkesat e të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës janë të pabazuara, duke i propozuar Gjykatës Supreme që t'i refuzoj ato.

## **II. Gjetjet e Gjykatës Supreme**

### **1. Pranueshmëria e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pranueshme. Është paraqitur pranë gjykatës kompetente sipas nenit 453 të KPPK-së, dhe brenda afatit kohor të përcaktuar me nenin 452, par. 3 të KPPK-së.

### **2. Procedurat e ndjekura nga Gjykata Supreme**

Kolegji i Gjykatës Supreme ka vendosur në seancë sipas nenit 454, par. 1 të KPPK-së. Palët nuk janë njoftuar lidhur me seancën, pasi që sipas neneve 451 deri 460 të KPPK-së Gjykata Supreme nuk është e obliguar që t'i njoftoj palët.

### **3. Mbi meritat e Kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë**

#### **a. Kërkesa e avokatit mbrojtës e datës 25 nëntor 2009:**

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Avokati mbrojtës në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë të datës 25 shtator 2009, ka kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së 2-të të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ap.Kz.Nr.179/2007) të datës 23 qershor 2009 si e bazuar në aktgjykimin e shkallës së 1-rë të Gjykatës së Qarkut në Gjilan (P.Nr. 142/04) të datës 19 maj 2005, edhe pse ky aktgjyrimi në mënyrë esenciale kishte shkelur procedurën penale të përcaktuar posaçërisht me nenin 403, paragrafin 1. pikën 12 të KPPK-së si dhe Ligjin penal siç përcaktohet me nenin 404 të KPPK-së.

Përveç kësaj, avokati mbrojtës ka kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së 2-të të Gjykatës Supreme të Kosovës për shkak të shkeljes së Ligjit Penal të Kosovës.

Nuk ka shkelje të nenit 403, par. 1, nën-par. 1 të KPPK-së.

#### **aa. Shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale (neni 402, paragrafi 1, pika 1 lidhur me nenin 403 të KPPK-së):**

##### **(1) Shkeljet e pretenduara të nenit 403, par. 1, nën-par. 1, pikës 12 të KPPK-së nga gjykata e shkallës së parë.**

Avokati mbrojtës ka theksuar se posaçërisht aktgjyrimi i shkallës së 1-rë i Gjykatës së Qarkut në Gjilan në mënyrë esenciale shkel ligjin e procedurës penale, siç do të ishte e pakuptueshme, kundërtshënës në brendi tij dhe me arsyet e dhëna, dhe këto të fundit nuk do të ishin bindëse lidhur me faktet vendimtare kurse arsyet respektive do të ishin në mënyrë të konsiderueshme të paqarta dhe kundërtshënës në mes veti si dhe me përmbajtjen e shkresave të lindës dhe procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor.

Prandaj, aktgjykimi i shkallës së parë do të ishte konfuz deri në atë masë sa që nuk do të mund të studiohet lidhur me atë se çfarë ka marrë parasysh gjykata si fakte relevante për vendosjen e kësaj lënde.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se ky shqetësim tërësisht i referohet nenit 403, paragrafit 1, pikës 12 të KPPK-së mirëpo që pretendimi nuk qëndron përkundër faktit që nuk vërtetuar fare. Gjykata Supreme në veçanti ka identifikuar se aktgjykimi i shkallës së parë i Gjykatës së Qarkut në Gjilan është shumë i qartë lidhur me atë se për cilat pika të aktakuzës i akuzuari është shpallur fajtor, për të cilat është liruar, çfarë dënimi i është shqiptuar, dispozitat e ligjit të aplikuara, si dhe gjetjet faktike lidhur me pranueshmërinë dhe vlerësimin e dëshmimeve.

Në këtë kontekst, gjykata e shkallës së dytë tanimë ka vendosur si në vijim:

"- Tanimë siç është vërejtur më lart (shih pikën II.1) me ligj nuk kërkohet që dispozitivi të përmbajë një përshkrim të detajuar të sjelljes së personit të dënuar, sidoqoftë, ai duhet të jetë i "kuptueshëm", që do të thotë se ajo që i pandehuri ka bërë.

Në këtë rast dispozitivi duket të jetë shumë i qartë sa i përket sjelljes së secilit të pandehur, përfshirë edhe atë të 1 R.

Në fakt sqaron se më 17 mars atje ishte një turmë e madhe e zemëruar e cili ka sulmuar S.F., nënën e tij dhe pronën e tij në Gjilan.

Në këto rrethana i pandehuri N.R., duke vepruar mizorisht dhe dhunshëm, ka shkaktuar vdekjen e S.F.

Pas sulmit kundër pronës, R. dhe turma e zemëruar kanë përcjellur P. R. e ka goditur viktimën dy herë me shkop, një herë në duar dhe një herë në kokë, pastaj ai ka kërcyer në trupin e viktimës.

Kjo sjellje dhe ajo e të bashkëpandehurve të tjerë të cilët e kanë sulmuar P. me shkopinj dhe gurë, e ka privuar viktimën nga jeta.

Dispozitivi shton përcaktimin ligjor të sjelljes së përshkruar faktike të të pandehurve dhe kryerësve të tjerë.

Dispozitivi përmban të gjitha elementet e kërkuar me ligj dhe nuk ka asnjë kundërthënie në brendi.

- Sa i përket mungesës së pohuar të arsyeve bindëse lidhur me faktet vendimtare, pjesa e arsyetimit ekzaminon deklaratat dhe mbrojtjen e R. i shumë pika. Deklaratat e tij janë konfrontuar me ato të dëshmitarëve të prokurorit si A. U. B.T.H. J.L. dhe të tjerët.

Deklaratat e tij gjatë gjykimit janë ekzaminuar (faqe 38) në veçanti lidhur me konsistencën e tyre.

Gjykata e shkallës së parë shqyrton çështjen e pranueshmërisë së deklaratave të tij në Polici (faqet 44 dhe 45).

Përfundimisht (faqet 47 dhe 48) ekzaminojnë bazat e dënimit të këtij të pandehuri.

Të gjitha elementet e paraqitura nga aktgjykimi i atakuar duket të jenë koherente me njëra tjetrën, bindëse dhe shpien në rezultatin e njëjtë të dispozitivit.

- Dëshmitë në të cilat Gjykata e Qarkut e ka bazuar aktgjykimin e saj lidhur me **N.R.O.** janë treguar në mënyrë të qartë në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit pa kontradikta.

Pasi që gjykata ka sqaruar se cilat dëshmi i ka konsideruar si të besueshme dhe arsyet për këtë zgjedhje (që janë deklaratat e të pandehurit në Polici, shih faqe 41) pastaj në mënyrë koherente iu ka përmbajtur zgjedhjes së saj.

Arsyet për dënimin e **R.O.** bazohen në deklaratat e **A.S.**

- **Xh.S.** dhe **A.A.** [në Polici.
- **A.S.** kujton:
- Se ai së bashku me shokët e tij **R.** dhe **A.** ndihmuan të tjerët në djegien e një veture me targa Serbe,
- Se ata të tre iu bashkuan protestuesve dhe gjuajtën gurë në shtëpinë e viktimës Serbe,
- Se në atë moment viktimë doli jashtë shtëpisë me armë dhe shkoi në drejtim të nëndrës **D.** e përcolli atë "me shkop në dorën e tij", po ashtu **I.** dhe **A.** e përcollën viktimën,
- Me atë shkop **R.** e goditi Serbin në duar, kështu që arma dhe po ashtu viktimë ranë në tokë,
- se **Xh.** nori me vete armën automatike,
- se pas kësaj "u bë rrëmujë" sepse turma e goditi Serbin me gurë dhe shkopinj druri."

Gjykata Supreme i drejtohet në tërësi këtij arsyetimi për të refuzuar kërkesën e Avokatit mbrojtës si të pabazuar.

## (2) Shkelja e pretenduar e nenit 403, paragrafit 2, pikës 2 të KPPK-së.

Së fundi, Avokati mbrojtës në kontekst të Aktgjykimit të shkallës së parë potencoi se nuk i janë dorëzuar atij procesverbalet e përkthyer të shqyrtimit gjyqësor, edhe pse ai e ka kërkuar këtë gjatë tërë procedurës. Prandaj, është krijuar një pengesë serioze për mbrojtje efikase të cilësisë së lartë.

Gjykata Supreme kupton se Avokati mbrojtës në këtë mënyrë kundërshton Aktgjykimin e shkallës së parë – si dhe Aktgjykimin e shkallës së dytë për mbështetjen tij – për shkeljen e të drejtave të mbrojtjes të përcaktuara me nenin 403, paragrafin 2, pikën 2 të KPPK-së.

Pikë së pari, është e rëndësishme se duke u bazuar në ligj gjykata e shkallës së parë nuk kishte obligim të dorëzojë avokatit mbrojtës procesverbalin e përkthyer të shqyrtimit gjyqësor. Neni 77, paragrafi 3 i KPPK-së në mes tjerash arsyeton se "mbrojtësi ka të drejtë të shikojë shkresat dhe provat e çështjes në pajtim me dispozitat e këtij kodi evidence". Po ashtu, neni 142, paragrafi 1 i KPPK-së përcakton duke përdorur fjalë të ngjashme se "në asnjë fazë të procedurës mbrojtësi



nuk mund t'i mohohet shikimi i shkresave të marrjes në pyetje të të pandehurit ...". Prandaj, Gjykata Supreme kupton se ligji në fuqi nuk obligon gjykatën të jetë proaktive pra t'i dërgojë kopjet e përkthimeve të gati të gjitha shkresave të lëndës te Avokati mbrojtës pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

Përveç kësaj, Gjykata Supreme konstaton se vetë i akuzuari ishte vazhdimisht i pranishëm gjatë shqyrtimit gjyqësor të shkallës së parë. Si dhe, më 17 janar 2005 Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Gjilan caktoi avokatin e tanishëm mbrojtës *ex officio* për të pandehurin, i cili prej asaj kohe ishte po ashtu i pranishëm vazhdimisht gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe prandaj kishte të gjitha mundësitë dhe shanset të jetë i përgatitur në mënyre adekuate për seancat dhe përmbajtjen e tyre. Kishte vetëm një seancë (më 22 mars 2005) kur avokati mbrojtësi i të pandehurit caktuar *ex officio* nuk ishte i pranishëm në gjykim, por ishte zëvendësuar nga avokat *L. G.S.* në mënyrë adekuate dhe ligjore.

### (3) Shkelja e nenit 395, paragrafit 1 të KPPK-së.

Së fundi, duhet të adresohet çështja e kohës së gjatë deri sa është paraqitur arsyetimi i aktgjykimit me shkrim. Në këtë kontekst, dhe duke marrë parasysh nenin 6 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), Aktgjykimi i shkallës së dytë potencoi si në vijim:

*Veçanërisht koha e kaluar nga shpallja e aktgjykimit dhe përpilimi dhe dorëzimi i aktgjykimit është definuar si e tepruar nga ana e avokatit mbrojtës i N. R. i cili potencon se ky i pandehur ishte në paraburgim gjatë kohës ku gjykata ka përgatitur aktgjykimin me shkrim. Në këtë rast sipas nenit 395.1 të KPPK-së aktgjykimi duhet të dorëzohet brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga shpallja e tij. Një vlerësim analog mund të bëhet edhe për Xh.S. i cili ishte vazhdimisht në paraburgim që prej datës 31 mars 2004, gjersa ankuesit tjerë ishin liruar para shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë.*

*Kjo lëndë është e veçantë sa i përket kompleksitetit: shkalla e parë kishte të bëjë me gjashtë të pandehur, secili prej tyre i akuzuar për vepra penale specifike, gjatë shqyrtimit gjyqësor ishin dëgjuar tridhjetë e pesë dëshmitarë dhe u nevojitën njëzet e gjashtë shqyrtime, për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë çdo gjë ishte përkthyer në gjuhën angleze dhe shqipe, përmasat e shkresave të lëndës përfshinin më shumë se tre mijë faqe, aktgjykimi me shkrim ishte pesëdhjetë e gjashtë faqe.*

*Nuk mohohet se ky ndërlikim kërkon kohë për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, për marrjen e vendimit dhe shkrimin e aktgjykimit.*

*Aktgjykimi i shkallës së parë u shpall më 19 maj 2005; vendimi me shkrim është paraqitur në shkrimore të Gjykatës së Qarkut në Gjilan UNMIK më 29 nëntor 2006.*

*Ankesa e fundit është paraqitur më 26 janar 2007; seanca ankimore nuk ishte caktuar para dorëzimit të kësaj lënde te EULEX-i më 30 janar 2009. Kjo gjykatë mendon se koha ashtu siç pohohet ishte shumë e gjatë dhe nuk ishte në përputhje me kohëzgjatjen e "arsyeshme" të procedurës të përcaktuar me konventa ndërkombëtare.*

Duke u bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe legjislacionin e Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës zgjatja e "paarsyeshme" e procedurës mund të drejtoj deri në një formë kompensimi ekonomik.

Kjo gjykatë nuk është kompetente për të vendosur mbi formën e kompensimit ekonomik bazuar në vonesën e paarsyeshme të procedurës penale.

Megjithatë, në rast të dënimit, kjo pikë mund të konsiderohet nën dispozitën e nenit 66 nr. 2 të KPPK-së si rrethanë lehtësuese<sup>1</sup>, e cila megjithatë duhet të krahasohet me rrethanat rënduese dhe peshën e veprës.

Sidoqoftë, Gjykata Supreme tani konstaton se kjo pikë, e cila nuk bie nën nenin 403 të KPPK-së ku nuk mund të vlerësohet *ex officio*, nuk ishte kundërshtuar nga Mbrojtja (neni 455, paragrafi 1 i KPPK-së).

**bb. Shkelja e ligjit penal (neni 402 paragrafi 1 pika 2 lidhur me nenin 404 të KPPK-së):**

Edhe pse Avokati mbrojtës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë ka propozuar të kundërshtohet Aktgjykimi i shkallës së parë për shkak të shkeljes së ligjit penal, asnjëherë nuk është sjellë përpara një arsyetim i qartë kundër Aktgjykimit.

Gjykata Supreme prandaj kupton se qëllimi i Avokatit mbrojtës është të theksohet se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan është i bazuar në prova jo ekzistuese sa i përket asaj që i akuzuari është shpallur fajtor për vrasjen e S.F. dhe janë injoruar rrethanat të cilat do ta kishin parandaluar të akuzuarin të ndjekej penalisht dhe të dënohej në këtë lëndë.

Gjykata e shkallës së parë – përkrahur edhe nga gjykata e shkallës së dytë – ka bërë një vlerësim të hollësishëm dhe të plotë mbi pranueshmërinë dhe besueshmërinë e të gjitha dëshmive, të cilave i adresohet edhe kjo Gjykatë. Sa i përket vlerësimit të deklaratave të bashkë të pandehurve, gjykata e shkallës së dytë konstaton:

"asnjë kundërtënie në mes arsyeve të dhëna nga Gjykata e Qarkut dhe provave të mbledhura nuk mund të gjendet në aktgjykimin e kundërshtuar.

Mund të shtohet se R. vetë pranoi para Policisë se ka takuar I. dhe A. se i është bashkëngjitur një grupi protestuesish që gjuanin gurë në shtëpinë Serbe, se ka marrë pjesë bashkë me shokët e tij në gjuajtjen e gurëve, se ka përcjellë personin Serb kur ai ishte duke ecur në rrugë, se ka sjellë në dorën e tij një shkop, se në këtë rast ishte përcjellë nga I. dhe A. I.

Kjo Gjykatë...ndan vlerësimin e gjyqtarit të parë, duke marrë parasysh se deklaratat e para ishin të vërteta, të paprishura nga gjërat e mësuara nga deklaratat e të pandehurve tjerë apo nga dashja e thjeshtë për tu mbrojtur.

<sup>1</sup> Në këtë kuptim në krahasim me Gjykatën e Qarkut në Prishtinë 9 nëntor 2007 ; S.H.M. Gjykatën e Qarkut në Prishtinë 5 tetor 2007 B.M dhe Gjykatën Supreme të Kosovës 10 prill 2009 ; S.K. et al.

Lidhur me sjelljen e *NoRo* dhe *Xh.S.* dhe *A.A.* dëshmia e dhënë nga *A.I.* I para Policisë mund të kompletohet nërmes deklaratave të dhëna në rrethana të njëjta nga vetë i pandehuri.

*R.* Ioi se ka qenë i pranishëm gjatë trazirave së bashku me *I.* dhe *A.* se kishte gjuajtur gurë në shtëpinë e viktimës, se kishte përcjellë auke mbajtur një shkop në dorën e tij.

*Sop.* Të gjitha këto elemente përputhen me njëra tjetrën në kuptim të asaj që është shprehur me anë të aktgjykimit të gjyqtarit të parë.

- sa i përket rezultatit të ekspertizës së rrobave dhe këpucëve të *R.* vërehet se ky i pandehur ishte intervistuar nga Policia më 6 prill 2004, 20 ditë pas fakteve. Se më 17 mars ai kishte veshur rroba dhe mbathur këpucë të caktuara është vetëm një supozim i tij i pavërtetuar.

Përveç kësaj, para intervistimit nga Policia *R.* kishte gjithë atë kohë për të pastruar rrobat dhe këpucët.

- Sjellja e *S.P.* duke ecur në rrugë me Kallashnikov në dorë nuk mund të konsiderohet jashtë kontekstit të përgjithshëm të fakteve të asaj dite.

Ai doli nga shtëpia e tij pasi ishte sulmuar dhunshëm nga një turmë e madhe dhe e inatosur duke e gjuajtur me gurë.

*A.* kujton veçanërisht se gjatë këtij sulmi ndaj shtëpisë ai kishte parë personin Serb duke shikuar përmes një dritareje të shtëpisë.

Kur *P.* më në fund doli jashtë atij i rridhte gjak nga koka e tij, një shenjë se gjuajtjet në shtëpinë e tij e kishin goditur edhe trupin e viktimës.

Peric përdori armën për tu mbrojtur nga një aksion që mund të konsiderohet si kërcënim.

Ai nuk kishte shtënë, siç vërtetohet nga dëshmitarët dhe nga numri i plumbave të gjetur në karikatorin e armës pas disa ditëve.

Ai ishte rrethuar nga një turmë e madhe dhe e inatosur që kishte sulmuar shtëpinë e tij dhe e kishin lënduar.

Sjellja e tij nuk mund të konsiderohet si një rrezik i jashtëligjshëm për protestuesit në turmë por vetëm si një mjet për mbrojtje të domosdoshme: ai ishte nën sulm të pashmangshëm real dhe të paligjshëm dhe veprimi i tij (të kërcënojë turmën për të qarë rrugën) ishte proporcional me shkallën e atij rreziku (neni 8 KPPK).

Sjellja e *Sop.* nuk arsyeton atë të turmës, dhe nuk përbën rrethanë lehtësuese për kryerësit".

**cc. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike (neni 402, paragrafi 1, pika 3 lidhur me nenin 405 të KPPK-së):**

Avokati mbrojtës, prapë pa arsyetim të vërtetuar, kundërshton se Gjykata e shkallës së parë, në këtë rast e mbështetur nga Gjykata e shkallës së dytë, ka marrë parasysh deklaratat e dëshmitarit të dhëna në polici. Është propozuar se këto deklaratat janë kundërshtuar nga i akuzuari kurse bashkë të pandehurit tjerë kishin mohuar të gjitha deklaratat e dhëna në polici, duke shfajësuar të akuzuarin. Ende në pozitë mbrojtëse,

duke ditur se këto rrethana nuk ishin marrë parasysh në tërësi nga Gjykata e Qarkut, do të mungojnë provat për të dënuar të pandehurin.

Edhe pse nuk përmendet shprehimisht në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme kupton se qëllimi i Mbrojtjes është të potencojë se Gjykata në Aktgjykimin e saj ka vërtetuar gjendjen faktike gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë, siç përcaktohet me nenin 405 të KPPK-së.

Në këtë masë, Gjykata Supreme shprehimisht i referohet nenit 451, paragrafit 2 të KPPK-së, i cili qartazi përcakton se *“kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike ....”*. Prandaj, vlerësimi mbi rikonstruktimin e gjendjes faktike nuk mund ti nënshtrohet shqyrtimit të Gjykatës Supreme në këtë kontekst.

Për të qenë të kujdesshëm në shqyrtimin e aspekteve të kundërshtuara, Gjykata Supreme nënvizon se Aktgjykimi i shkallës së parë pasqyron hollësisht peshimin e provave në Gjykatën e Qarkut, posaçërisht kur kemi të bëjmë me deklaratat e dëshmitarëve si dhe të bashkakuzuarit apo vetë të pandehurit. Gjykata e shkallës së parë ka bazuar vendimin e vet në të gjitha provat e vlerësuara me kujdes të konstatuara si të pranueshme. Prandaj, nuk është vërtetuar asnjë konstatim i gabueshëm e jo i plotë i gjendjes faktike nga Gjykata e shkallës së parë.

**dd. Shkeljet e pretenduara të nenit 403, par. 1, nën-par. 1 pikës 12 të KPPK-së nga Gjykata e Shkallës së Dytë**

Avokati mbrojtës ka potencuar se Aktgjykimi i shkallës së dytë ishte i pakuptueshëm, sepse nuk ka qenë e mundur të konstatohet “çka është pranuar e çka është refuzuar”.

Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të Aktgjykimit, konstaton se pretendimi i ngritur është i pabazuar. Gjykata e shkallës së dytë pranoi pjesërisht ankesën e paraqitur në dobi të të pandehurit sa i përket ri-cilësimit juridik të veprës penale të Vrasjes së rëndë në kundërshtim të nenit 147 të KPK-së në atë të Vrasjes në kundërshtim të nenit 30, paragrafit 2, pikës 5 të KP të KSAK-së, por refuzoi ankesën sa i përket pjesës së mbetur. Në këtë mënyrë, Aktgjykimi i shkallës së parë ishte vërtetuar pa marrë parasysh cilësimin juridik të veprës penale të Vrasjes së rëndë siç u tha më lart.

Nuk mund të ngrihen dyshime serioze sa i përket kësaj, pasi që formulimi i fjalëve në Aktgjykimin e shkallës së dytë dhe referimit të saj në vendimin e shkallës së parë e bëjnë të qartë se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjiilan ishte vërtetuar sa i përket:

- Dënimin për veprën e ri-cilësuar penale Vrasje e rëndë në Vrasje në kundërshtim të nenit 30, paragrafit 2, pikës 5 të KP të KSAK-së (15 vjet burgim);
- Dënimin për veprën penale Pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale në kundërshtim të nenit 200, paragrafit 1 të KP të KSAK-së;

- Dënimit për veprën penale Pjesëmarrje në grup që kryen veprë penale (2 vjet e 6 muaj burgim);
- Dënimit unik me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim.

#### ee. Shkeljet tjera të ligjit penal të pohuara nga Gjykata e shkallës së dytë

Përfundimisht, avokati mbrojtës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë ka kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së dytë për ri-cilësimin e veprës penale vrasje e rëndë dhe dënimin e të akuzuari sipas nenit 30, par. 3, pikës 5 të KP të KSAK-së, në vend të nenit 147 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), edhe pse ai nuk kishte propozuar një gjë të tillë në ankesën e vet dhe për shkak se dispozita e mëhershme do të ishte më e favorshme.

Pas shqyrtimit të kujdesshëm të aktgjykimin të shkallës së dytë, Gjykata Supreme konstaton se ri-cilësimi i veprës penale të Vrasjes së rëndë është bërë në mënyrë të qartë në favor të të pandehurit. Në këtë kuptim, Gjykata Supreme i referohet arsyetimit të aktgjykimin të shkallës së dytë, i cili konstaton si më poshtë:

*Gjykata e shkallës së parë ka zbatuar gabimisht lidhur me veprën penale të vrasjes së rëndë dispozitat ligjore të neneve 146 dhe 147, pikën 5 të KPPK-së (lidhur me nenin 23 për R<sub>e</sub> dhe nenin 25 për S<sub>e</sub> në vend të dispozitës së duhur ligjore të nenit 30, par. 2, pikës 5 të Ligjit Penal të Kosovës (lidhur me nenet e Kodit penal të RSFJ-së, 22 për l R<sub>e</sub> dhe 24 për l S<sub>e</sub>).*

*Çështja e ligjit të zbatueshëm së pari duhet të zgjidhet përmes zbatimit të ligjit në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale: në këtë kuptim nenit 2, paragrafit 1 të KPPK-së dhe nenit 4, par. 1 të KP të RSFJ-së.*

*Të dy dispozitat e përmendura parashohin mundësinë e ndryshimit në ligjin penal gjatë periudhës më mes të faktit dhe të vendimit të formës së prerë rreth tij, kur do të zbatohet ligji më i favorshëm (ose më pak i rreptë) (shih nenin 2, par. 2 të KPPK-së dhe nenin 4, par. 2 të KP të RSFJ-së).*

*Në këtë rast, krimi i pohuar i vrasjes së rëndë është kryer më 17 mars 2004, para se KPPK-ja të hynte në fuqi, d.m.th. në kohën kur në fuqi ishte LPK-ja me dispozitat e veta.*

*Gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar këtë çështje (faqet 51 dhe 52) dhe ka vendosur të zbatojë ligjin e ri (nenet 146 dhe 147, lidhur me nenin 23) sepse kjo gjë është konsideruar të jetë më e favorshme për të pandehurin.*

*Kjo gjykatë konsideron se duhet zbatuar ligjin e vjetër (nenin 30, par. 2, pikën 5 të LPK-së), sepse ligji i ri nuk është më i favorshëm për të pandehurin.*

*Sipas dispozitave ligjore të LPK-së, fakti në fjalë është i dënueshëm me dhjetë deri në dyzet vjet burgim.*

*Është një lloj unik i dënimin (me burgim) sepse Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/59, neni 1.6 ka zëvendësuar dënimin me vdekje, të përcaktuar fillimisht nga LPK-ja, me dënim maksimal prej dyzet vjetësh burgim.*

*Sipas nenit 38 të KP të RSFJ-së, personi i dënuar me burgim mund të fitojë lirin me kusht pasi të ketë vuajtur gjysmën e dënimit të tij.*

*Neni 147 i KPPK-së përcakton dy lloje dënimesh: dhjetë deri në njëzet vjet burgim (lexo nenin 147 së bashku me nenin 38, par. 1 të KPPK-së) dhe burgim afatgjatë që d.m.th. njëzet deri në dyzet vjet burgim (shih nenin 37, par. 2 të KPPK-së).*

*Duhet patjetër të theksohet se burgimi afatgjatë është më pak i favorshëm sesa burgimi i paraparë me nenin 30 të LPK-së, edhe pse kohëzgjatja maksimale është e njëjtë.*

*Kjo ndodh për shkak të dy arsyeve: minimumi i burgimit afatgjatë (njëzet e një vjet) është më shumë sesa minimumi i burgimit (dhjetë vjet); personi i dënuar me burgim afatgjatë mund të fitojë lirim me kusht vetëm pas vuajtjes së tri të katërtave të dënimit dhe jo gjysmës së tij.*

*Sipas ligjit të ri, gjyqtari ka mundësinë të zgjedhë në mes të burgimit dhe burgimit afatgjatë; që d.m.th. ka mundësinë të caktojë një dënim (burgim afatgjatë) i cili është më pak i favorshëm sesa dënimi i paraparë me ligjin e vjetër.*

*Për këto arsye, në rast se të pandehurit dënohen, patjetër duhet të zbatohet neni 30, par. 2, pika 5 e Ligjit Penal të Kosovës.*

*Nuk mund të shihet ndonjë dallim përmbajtësor në mes të nenit 22 të KP të RSFJ-së dhe nenit 23 të KPPK-së.*

*Në fund, mund të thuhet se gjyqtari i parë me të drejtë ka zbatuar nenin 200, par. 1 të LPK-së si ligj që ka qenë në fuqi në kohën e veprës në vend të nenit 320 të KPPK-së, sepse këto dy dispozita ligjore janë të ngjashme sa i përket dënimit.*

Fakti që ri-cilësimi i krimit nuk ka pasur ndonjë efekt mbi dënimin, i cili mbetet 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim, nuk ka ndikim në vlerësimin ligjor të përmendur më lart sepse ai është më i favorshëm sesa vlerësimi tjetër me përmbajtje të njëjtë juridike. Nuk ka garanci se i akuzuari do të përfitojë çdo herë nga obligimi i gjykatës për të zbatuar ligjin më të favorshëm.

Tashmë, Gjykata e shkallës së dytë ka konstatuar sa vijon:

*“Gjykata e parë konsideron se si rrethanat rënduese (shkalla e përgjegjësisë penale, motivet për kryerjen e veprës, rrethanat e veçanta, brutaliteti i aktit, pesha e veprave) ashtu edhe rrethanat lehtësuese (sjellja e mëhershme, dosja e pastër, mosha e njomë, rrethanat personale dhe familjare të të pandehurit), kanë përcaktuar dënimin për vrasje të rëndë në pesëmbëdhjetë vjet dhe dënimin për veprën penale të përcaktuar me nenin 200.1 të LPK-së në dy vjet e gjashtë muaj.*

*Dënimet pra janë përcaktuar të jenë afër minimumit.*

*Dënimi unik ka qenë gjashtëmbëdhjetë vjet burgim.*

*Sipas nenit 64.1 të KPPK-së dënimi përcaktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe duhet të jetë proporcional me peshën e veprës, sjelljen dhe rrethanat e të pandehurit.*

*Kjo gjykatë pajtohet me vlerësimin e gjyqtarit të parë mbi ekzistimin edhe të rrethanave rënduese dhe të atyre lehtësuese.*

*Këtij të pandehuri mund t'i njihet edhe rrethana lehtësuese që ka të bëjë me kohën e stërzgatur për dorëzimin e aktgjykimit të shkallës së parë.*

*Megjithatë, pësia e veprës dhe motivet e saj që lidhen me urrejtjen kundër etnisë tjetër duket të jenë aq të larta sa të mbizotërojnë çdo rrethanë lehtësuese.*

*Kohëzgjatja e dënimit mbetet e njëjtë siç është vendosur edhe nga Gjykata e shkallës së parë edhe pse cilësimi juridik i krimit të vrasjes së rëndë duhet patjetër të bazohet në nenin 30, par. 2, pikën 5 të LPK-së e jo në nenin 146 dhe 147, pika 5 e KPPK-së. Në këtë rast, dënimi i caktuar (pesëmbëdhjetë vjet) përputhet me kushtet ligjore të përcaktuara me ligjin në fuqi”.*

Gjykata Supreme i referohet plotësisht këtij arsyetimi.

#### **b. Kërkesa e të pandehurit e datës 25 nëntor 2009:**

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazë.

I pandehuri në kërkesën e vet për mbrojtje të ligjshmërisë, të datës 25 nëntor 2009 ka kundërshtuar edhe Aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit (P. Nr. 142/04) të datës 19 maj 2005, edhe Aktgjykimin e shkallës së dytë të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ap. Kz. Nr. 179/2007), të datës 23 qershor 2009, për shkak të shkeljes esenciale të procedurës penale të përcaktuar me nenin 403, par. 1, pikat 3, 8 dhe 9 të KPPK-së. Po ashtu i pandehuri e kupton se të dy gjykatat kanë shkelur parimin *ne bis in idem*.

Sa u përket të dy aktgjykimeve, i pandehuri ka theksuar gjithashtu shkeljen e pohuar të ligjit penal të përcaktuar me nenin 404 të KPPK-së, pasi që ai është shpallur fajtor për vrasje të rëndë në shkallën e parë dhe pasi që në shkallën e dytë gjykata kishte zbatuar gabimisht nenin 30 të KP të RSFJ-së në vend të nenit 147 të KPPK-së.

#### **aa. Shkeljet e pohuara të kodit të procedurës penale**

(1) I pandehuri ka theksuar keqtrajtimin gjatë marrjes në pyetje në polici dhe në prokurori, duke pretenduar se para se të merrej në pyetje nga ana e Prokurorit, policia ia kishte marrë atletet, kështu që si pasojë e kësaj atij iu desh të paraqitej këmbëzbathur para Prokurorit. Për më tepër, Gjykata e shkallës së parë kishte konsideruar si të pranueshme të gjitha deklaratat e marra nga policia, edhe pse ShPK-ja dhe Policia e UNMIK-ut kishin qenë të suspenduara nga KFOR-i gjatë trazirave të marsit, kështu që të gjitha këto hetime janë zhvilluar duke shkelur Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/28 mbi të drejtat e personave të arrestuar.

Gjykata Supreme e kupton qëllimin e të pandehurit se sipas mendimit të tij këto aktgjykime janë bazuar në dëshmi të papranueshme, siç përcaktohet me nenin 403, par. 1, pika 8 e KPPK-së.

Gjykata Supreme e ka të qartë se – përderisa KFOR-i sipas mandatit të tij duhej të ruante rendin dhe qetësinë sa më shumë që kishte mundësi – UNMIK-u dhe ShPK-ja në rastin në fjalë vetëm kishin asistuar në mbledhjen dhe në ruajtjen e dëshmive. Prandaj, Gjykata Supreme nuk sheh ndonjë shkelje të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/28, të kundërshtuar nga i pandehuri.

Për më tepër, i pandehuri në këtë kuptim ka theksuar se ishte intervistuar nga policia në mënyrë të parregullt, pasi që atij iu desh të jepte deklaratën pasi policia ia kishte konfiskuar këpucët.

Gjykata Supreme konstaton se ky pohim tashmë është trajtuar me aktgjykimin e shkallës së dytë. Kjo ankesë ka konstatuar keqtrajtimi i pohuar me rastin e konfiskimit të këpucëve gjatë marrjes në pyetje nuk mund të pranohet si keqtrajtım, pasi që sipas dëshmive të policëve këpucët i janë hequr të pandehurit pas e jo gjatë marrjes në pyetje (Gjykata Supreme e Kosovës, Ap.-Kz. No. 179/2007, më 23 qershor 2009, faqe 15 në versionin në gjuhën angleze).

(2) Përveç kësaj, i pandehuri ka theksuar se Gjykata e shkallës së parë nuk e ka lënë të jetë i shoqëruar tërë kohën nga avokati i tij mbrojtës dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 73 të KPPK-së duke zbatuar gabimisht nenin 69 të KPPK-së.

Gjykata Supreme e ka të qartë se i pandehuri dëshiron të shprehë mendimin e vet se ai kishte të drejtën e mbrojtjes së detyruar dhe se shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mungesë të personave prania e të cilëve është kërkuar nga i akuzuari, siç përcaktohet me nenin 403, par. 1, pika 3 e KPPK-së.

Gjykata Supreme tashmë ka theksuar se që nga data 17 janar 2005 i pandehuri ka pasur mbrojtje të detyrueshme (përveç periudhës nga data 22 mars 2007, kur i është gjetur një avokat si zëvendësim) dhe se që nga ajo kohë ai ka qenë vazhdimisht i shoqëruar nga avokati nëpër seanca (faqe 9).

(3) I pandehuri në fund thekson se aktgjykimi i shkallës së dytë, përmes pranimit të gjetjeve faktike të aktgjykimimit të shkallës së parë, kishte shpërfillur faktin se – edhe pse ai ishte deklaruar i pafajshëm për të gjitha pikat – gjatë gjykimimit në shkallën e parë ai ishte dëgjuar para se të paraqiteshin të gjitha dëshmitë. Në këtë mënyrë ai kundërshton të dy aktgjykimet për shkelje të nenit 403, par. 1, pikës 9 të KPPK-së.

Në përgjithësi, vlen të theksohet se Gjykata e shkallës së dytë tashmë ka konstatuar se nuk pasur shkelje të nenit 403, par. 1, pikave 1, 2, 6, 8, 9, 10, 11 dhe 12 të KPPK-së, pikëpamje juridike kjo me të cilën pajtohet plotësisht Gjykata Supreme.



## bb. Shkeljet e pohuara të ligjit penal

(1) Sa i përket aktgjykimit të shkallës së parë, i pandehuri ka theksuar shkeljen e pohuar të ligjit penal të përcaktuar me nenin 404 të KPPK-së, pasi që është shpallur fajtor për Vrasje të rëndë edhe pse ai nuk kishte kryer krimin as nuk kishte dëshiruar një gjë të tillë dhe se dëshmitë që çuan Gjykatën në marrjen e vendimit të tillë ishin siguruar në mënyrë të paligjshme.

Gjykata Supreme tashmë ka theksuar se çështja e rekonstruktimit të gjendjes faktike bie nën nenin 405 të KPPK-së dhe ka të bëjë me vërtetimin gjoja të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, që sipas nenit 451, par. 1 të KPPK-së nuk bie nën shqyrtimin e Gjykatës Supreme në kontekstin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

(2) Sa i përket aktgjykimit të shkallës së dytë, i pandehuri gjithashtu ka theksuar shkeljen e pohuar të ligjit penal të përcaktuar me nenin 404 të KPPK-së, pasi që Gjykata Supreme kishte konstatuar gabimisht se neni 30, par. 2, pika 5 e KP të KSAK-së është ligj më i favorshëm sesa neni 147 i KPK-së dhe në këtë mënyrë kishte ri-cilësuar pjesërisht veprën penale, por pa zvogëluar dënimin e parë.

Gjykata Supreme në këtë kontekst tashmë ka theksuar se ri-cilësimi i krimit nuk duhet patjetër të ndikojë në dënim, i cili në rastin konkret mbetet 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim dhe se nuk ka garanci se i akuzuari përfiton diçka nga detyrimi i gjykatës për ta zbatuar ligjin më të favorshëm.

(3) Përveç kësaj, i pandehuri ankohet se të dy gjykatat e kishin shpallur atë fajtor për dy vepra penale – një vrasje të rëndë dhe një vepër penale të pjesëmarrjes në grupin që kryen veprën penale, edhe pse ai kishte kryer vetëm një vepër. Kjo ngase të dy gjykatat kanë shpërfillur parimin *ne bis in idem* dhe në këtë mënyrë kanë shkelur nenin 404 të KPPK-së.

Gjykata Supreme në këtë kuptim pajtohet plotësisht me atë që ka theksuar Gjykata e shkallës së dytë që është në harmoni me standardet ligjore ndërkombëtare dhe evropiane. Është e vetë-shpjegueshme se nuk është e pamundur të kryhen dy (ose madje edhe më shumë) krime në të njëjtën kohë, që d.m.th. të përmbushen kushtet e dy veprave të ndryshme penale të përcaktuara nga ligji përkatës penal përmes një veprimi ose sjelljeje të vetme. Ajo që është e papranueshme është rasti kur i pandehuri dënohet për të njëjtin fakt sipas dy apo më tepër procedurave të ndryshme ligjore, që d.m.th. ai dënohet dy herë për të njëjta veprime, gjë e cila shkel parimin juridik të *ne bis in idem*. Megjithëkëtë, një gjë e tillë nuk është dhënë në rastin konkret.

## 4. Konstatim i Gjykatës Supreme të Kosovës

Për arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme konstaton se Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të pabaza dhe për këtë arsye të njëjtat refuzohen.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 23 qershor 2009 (Ap.-Kz. Nr. 179/2007) VËRTETOHET NË TËRËSI.

Në pajtim me nenet 100 dhe 121 të KPPK-së, shpenzimet e procedurës penale i ngarkohen të pandehurit.

Rrjedhimisht, në pajtim me Nenin 456 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës vendos si në dispozitiv.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
Pkl-Kzz 131/09, 15 qershor 2010

Përgatitur në gjuhën angleze, si gjuhë të autorizuar.

Kryetari i kolegjit nga EULEX-i,  
Gerrit-Marc Sprenger

Zyrtari ligjor i EULEX-it si procesmbajtës,  
Andrea Chmieliński Bigazzi

Gjyqtari i EULEX-it,  
Norbert Koster

Gjyqtari kosovar,  
Avdi Dinaj

Gjyqtarja kosovare,  
Emine Kaçiku

Gjyqtarja kosovare,  
Emine Mustafa

**Këshillë juridike**

Kundër këtij Aktgjykimi nuk mund të paraqitet tjetër kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë (Neni 451, paragrafi 2 i KPPK-së).

Handwritten text, likely bleed-through from the reverse side of the page. The text is extremely faint and illegible due to the quality of the scan. It appears to be a list or series of entries, possibly names or dates, arranged in a somewhat regular pattern across the page.